



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1802/6 prot.

Datë 22.07.2025

V E N D I M
Nr. 944/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F., në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-50213-06-04-2025, me objekt: “Bojë dhe materiale speciale për vijëzimin e rrugëve (sinjalistike)”, me fond limit 4,103,317.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.

Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “I.D.K-Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F me NIPT K32725211G dhe adresë: Lagjia “Haxhias”, Elbasan.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “I.D.K-Konstruksion” SHPK, me NIPT K51408016J dhe adresë : Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12,

Rruga Zaja, Koder Bërxullë, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167, Vorë, Tiranë.

Operatori ekonomik “R. S. & M” SHPK, me NIPT K32203002I dhe adresë : Autostrada Tiranë-Durrës, Km.2.

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimes ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.06.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-50213-06-04-2025, me objekt: “Bojë dhe materiale speciale për vijëzimin e rrugëve (sinjalistike)”, me fond limit 4,103,317.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.

II.2. Në datë 16.06.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 25.06.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. ALMA KODRA PF	3,096,750	skualifikuar
2. I.D.K-KONSTRUKSION SHPK	3,457,500	skualifikuar
3. R. S. & M SHPK	3,851,500	kualifikuar

Operatori ekonomik “Alma Kodra” PF rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se: *“Referuar nenit 77 pika 1/b dhe 3 të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik”, Dokumentave të tenderit, (Kapaciteti ekonomik dhe financiar) pika 2.2.2 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit” nga verifikimet në dokumentat e ngarkuara në SPE, rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur vërtetimin për xhiron vjetore jo sipas viteve financiare të kërkuara nga autoriteti kontraktor por konkretisht vitet 2021, 2022, 2023 e cila nuk plotëson kushtet sipas përcaktimeve në DST.”*

II.4. Në datën 03.07.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraprak në sistemin e prokurimit elektronik.

II.5. Në datën 07.07.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5529 si dhe nr. protokolli 1802/2023 datë 08.07.2025, e operatorit ekonomik “Alma Kodra” PF, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, si dhe lënien të

skualifikuar të operatorit ekonomik “I.D.K-Konstruksion” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1802/1 datë 08.07.2025, lidhur me kërkesën e operatori ekonomik “Alma Kodra” PF, mbi shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “I.D.K-Konstruksion” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr.600 prot., datë 15.07.2025, me objekt “*Shkresë përcjellëse*”, autoriteti kontraktor, përmes sistemit të ankesave elektronike, ka përcjellë në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Të njëjtin informacion, shkresën nr.600 prot., datë 15.07.2025, me objekt “*Shkresë përcjellëse*”, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe përmes shërbimit postar, informacion i cili është protokolluar me tonën me nr. 1802/3 prot., datë 17.07.2025.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë dorëzuar argumente nga subjekte të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alma Kodra” P.F., mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “*Referuar nenit 77 pika 1/b dhe 3 të ligjit nr. 162/ 2020 “Për*

prokurimin publik”, Dokumentave të tenderit, (Kapaciteti ekonomik dhe financiar) pika 2.2.2 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit” nga verifikimet në dokumentat e ngarkuara në SPE, rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur vërtetimin për xhiron vjetore jo sipas viteve financiare të kërkuara nga autoriteti kontraktor por konkretisht vitet 2021, 2022, 2023 e cila nuk plotëson kushtet sipas përcaktimeve në DST.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcakruar kriterin si më poshtë:

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën (një) nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shpresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Vërtetim nr.T10640146, datë 22.05.2024 lëshuar nga drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, sipas të cilit rezulton se të ardhurat nga shitja e mallrave/shërbimeve janë;

në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitura për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:

Nr.	Periudha Tatimore	Shuma
1	23-A	
2	22-A	
3	21-A	

III.1.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Në nenin 43, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

4.Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.5 . Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se në pikën 2.2.2 të Dokumenteve të Tenderit, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se, për vlerësimin e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe aftësisë së tyre për të përmbushur me sukses kontratën, kërkohet paraqitja e xhiros vjetore për vitet financiare (**2022, 2023, 2024**), ku vlera e xhiros për të paktën (një) nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "Alma Kodra" P.F. rezulton se ky i fundit, në përmbushje të kërkesës së mësipërme, ka paraqitur Vërtetim nr.T10640146, datë 22.05.2024 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, sipas të cilit rezulton se të ardhurat nga shitja e mallrave/shërbimeve janë por vitin 2023 xxx lekë, vitin 2022 janë xxx lekë dhe për vitin 2021 janë xxx lekë. Rezulton se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2021-2022-2023, ku konstatohet se jo vetëm për një nga vitet, por për të tre vitet e deklaruara operatori ekonomik është në kushtet e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.2 të dokumentave të tenderit. Fakti që operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore të vitit 2024 të kërkuar në dokumentat e tenderit nuk mund të konsiderohet si mosplotësim i kriterit, për sa kohë operatori ka dorëzuar dokumentacionin nëpërmjet të cilit vërteton se përmbush kriterin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Ky i fundit në kriterin 2.2.2 ka përcaktuar qartë "*Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së*

kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”. Në kushtet kur ankimuesi ka arritur vlerën e xhiros së kërkuar, jo në një, por në dy nga vitet e kërkuara (2022, 2023) Komisioni vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F. përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.2.2 të dokumenteve të tenderit, dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm për qëllimet e vlerësimit të aftësisë financiare të këtij operatori.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Alma Kodra” P.F qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alma Kodra” P.F, mbi lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “I.D.K-Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), i ankimuesit nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, të cilët kanë ofertuar me një vlerë më të lartë ekonomike, ndaj dhe këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim nga ky Komision.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-50213-06-04-2025, me objekt: “Bojë dhe materiale speciale për vijëzimin e rrugëve (sinjalistike)”, me fond limit 4,103,317.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alma Kodra” P.F duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alma Kodra” P.F.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiovent Zguro

